

Date 17/04/2019

AKT THEMELIMI

I Shoqerise Aksionare “HBC Solutions” SH.A.

Ne mbështetje të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe të ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendren Kombëtare të Regjistrimit”, me vullnetin e tij të lire dhe të plote, i nënshkruari:

Bardhyl Hysenbelliu, shtetas shqiptar, madhor me zotësi të plote juridike për të vepruar, atësia Hasan, i datelindjes 27.05.1967, lindur në Skrapar dhe banues në Rr. “Pashko Vasa”, nr. 8, Tiranë, mbajtes i letërnjoftimit ID me nr. 033761089 dhe nr. personal G70527056Q,

VENDOSI:

Te themelojë shoqërinë aksionare “HBC Solutions” SH.A., sipas kushteve dhe afateve si vijon:

Dispozita të përgjithshme

Shoqëria “HBC Solutions” SH.A. themelohet në formën e një shoqërie aksionare me oferte private. Kjo shoqëri do të ushtrojë aktivitetin e saj në territorin e Republikës së Shqipërisë konform dispozitave të këtij akti themelimi, statutit të saj dhe legjislacionit në fuqi. Veprimtaria e kësaj shoqërie do të jetë me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës. Shoqëria do të ketë vullnet të saj.

Neni 1

Objekti i Veprimtarisë

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj si më poshtë:

Studime tregu e analiza marketingu. Shërbime në fushën e marketingut, tele-marketingut, web marketing etj. Projektimi dhe realizimi i fushatave publicitare dhe të marketingut nëpërmjet telefonit dhe internetit, për t'u shitur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Konsulencë dhe trajnime të ndryshme në fushën e tregtimit online nëpërmjet internetit. Kryerja e transaksioneve të blerjes dhe shitjes së titujve me porosi të klientit apo administrimi i portofolit të titujve në emër të një klienti që është pronar i portofolit. Veprimtaria e këshillimit për investime në tituj. Asistencë dhe konsulencë ligjore, financiare dhe të tjera. Shitje e pajisjeve informatike dhe ofrim i shërbimeve të IT, mirëmbajtje e riparime të rrjeteve kompjuterike e të tjera shërbime të ngjashme. Ofrimi i shërbimeve të ndërmjetësimit dhe çdo lloj aktiviteti tjetër të lejuar nga legjislacioni në fuqi.



Neni 2
Selia e Shoqerise

Selia e shoqerise **"HBC Solutions" SH.A.** do te jete ne adresen: **"Rruga e Kavajes", Ndertesa 134, Hyrja 9, Apartamenti 34, Tirane, Shqiperi.**

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filiale si brenda ashtu dhe jashte Republikes se Shqiperise ne perputhje me dispozitat e ligjit perkates dhe statutit.

Neni 3
Kohezgjatja e Shoqerise

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje afat kohor te pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit te saj prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

Neni 4
Kapitali i Shoqerise

Kapitali themeltar i shoqerise **"HBC Solutions" SH.A.** do te jete i perbere nga kontributi ne para i aksionerit themelues te kesaj shoqerie. Kapitali ne para do te jete ne vleren **3 500 000 (tremilion e peseqind mije) Leke**, i ndare ne **3500 (tremije e peseqind) aksione te zakonshme**, me vlere **1000 (njemije) Leke per aksion.**

Kapitali zoterohet 100% (njqind perqind) nga aksioneri themelues i shoqerise.

Transferimi i aksioneve mund te behet me ane te blerjes, shitjes, trashegimise, dhurimit ose menyrave te tjera te parashikuara me ligj.

Neni 5
Organet e Shoqerise

Organet drejtuese te shoqerise jane si me poshte:

1. Asambleja e pergjithshme e aksionereve
2. Keshilli i Administrimit
3. Administratori

Neni 6
Keshilli i Administrimit

Keshilli i pare i Administrimit te shoqerise perbehet nga tre anetare, te cilet jane caktuar si me poshte:

1. **Ardit Shehi**, shtetas shqiptar, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, atesia Xhevahir, lindur me 26.06.1987, ne Kastriot, Diber dhe banues ne Tirane, Rruga "Leka Zogu", Kamez, Tirane, mbajtes i leternjofimit Nr. 030277492 dhe numer personal I70626005T.
2. **Ledjan Shehu**, shtetas shqiptar, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, atesia Sami, lindur me 28.09.1992, ne Peshkopi dhe banues ne Tirane, Lagjja "Qesarake",



Njesia administrative "Dajt", mbajtes i leternjoftimit Nr. 033620508 dhe numer personal J20928063O.

3. **Fatjon Mahmutaj**, shtetas shqiptar, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, atesia Nasibi, lindur me 15.04.1984, ne Lushnje dhe banues ne Tirane, Rruga "Panorama", Ndertesa 10, Shk.1, Ap.24, mbajtes i leternjoftimit Nr. 029793436 dhe numer personal I40415036H.

Keta persona emerohen si anetare te pare te Keshillit te Administrimit deri ne zgjedhjen e tyre nga mbledhja e pare e Asamblese se Pergjithshme.

Neni 7 **Administratori**

Shoqeria administrohet nga administratori, i cili zgjidhet me **nje afat 3 (tre) vjecar**, me te drejte rizgjedhje. *Administratori i pare i shoqerise do te jete:*

***Fatjon Mahmutaj**, shtetas shqiptar, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, atesia Nasibi, lindur me 15.04.1984, ne Lushnje dhe banues ne Tirane, Rruga "Panorama", Ndertesa 10, Shk.1, Ap.24, mbajtes i leternjoftimit Nr. 029793436 dhe numer personal I40415036H.*

Shoqeria perfaqesohet perpara cdo organi administrative, gjyqesor, enti publik apo privat dhe ne marredhenie me te tretet nga administratori i shoqerise, i cili i ushtron keto te drejta ne perputhje me statutin e shoqerise dhe legjislacionin ne fuqi.

Neni 8 **Ekspertet Kontabel te Autorizuar (Audituesit Ligjore)**

Audituesit ligjore te shoqerise do te emerohen ne perputhje me ligjet ne fuqi dhe per cdo vit financiar te ushtrimit te veprimtarise se shoqerise sipas vendimit te Asamblese se Pergjithshme. Si Auditues i Pare ligjor do te emerohet shoqeria audituese **Crowe AL sh.p.k**, identifikuar me NIPT **K31516059K**, me administratore Audituesen Ligjore **Nexhmije Cela**.

Neni 9 **Pergjegjesite e paleve**

Te punesuarit dhe te ngarkuarit me drejtimin e shoqerise mbajne pergjegjesi dhe detyrohen te zhdemtojne shoqerine per demet qe i jane shkaktuar per faj te tyre gjate ushtrimit te veprimtarise se tyre.

Akti i themelimit u perpilua ne 3 (tre) kopje origjinale ne gjuhen shqipe.

AKSIONERI I SHOQERISE "HBC Solutions" SH.A.
BARDHYL HYSENBELLIU

